

Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Raportimi tek GIZ-SARED / AAM Aktivitetet e Grupeve të Zinxhirit të Vlerës datë 3 - 4 Mars 2017:

Rritja e të ardhurave për prodhuesit dhe grumbulluesit e Bimëve Aromatike dhe Medicinale (BAM) në Shkodër (2 grupe, në Tamarë dhe Shkrel)

OJF Zbatuese: Shoqata Shqiptare e Marketingut (ShShM)

Region and date	VC	NGO / association	Initiative /Component	No. of VC-groups	location	name of facilitator / expert	name of liaison - extension officer(s)
Shkodër 3 Mars 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Teuta Kllogjri p: +355 69 53 12 608 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: "Mundesite e Markave Rajonale".	1	Vrith / Shkrel, Shkoder	Besard Pudja / Iris Kazazi	DoA, Shkoder – Xheladin Zekaj
Shkodër 4 Mars 2017	MAP	AAM c: Besart Pudja p: +355 66 55 39 269 e: a.pudja@aam.al c: Teuta Kllogjri p: +355 69 53 12 608 e: info@aam.al	Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: "Mundesite e Markave Rajonale".	1	Tamara Shkoder	Besard Pudja / Iris Kazazi	DoA, Shkoder – Xheladin Zekaj

3 Mars 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Vrithit lidhur me: "Mundesite e Markave Rajonale".

Ekspert: Iris Kazazi, Ekstensionist pranë Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër: z. Xheladin Zekaj, datë 3 Mars 2017, fshati Vrith, Njësia Administrative Shkrel, Shkodër.

Në trajnim me temë "Mundesite e Markave Rajonale" morën pjesë 14 gra anëtare të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Vrithit. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e njohurive dhe kapaciteteve të grupit të zinxhirit të vlerës lidhur me rëndësinë e krijimit të markës rajonale që do të identifikojë origjinën gjeografike të produkteve, e cila luan gjithnjë e më shumë rol në vendimet e konsumatorit përfshirë edhe gadishmërinë për të paguar një çmim më të lartë, do të ndihmojë prodhuesit që të zhvillojnë besnikërinë e konsumatorit, duke sjellë kështu rritjen e të ardhurave, si dhe sigurimin e shitjeve të qëndrueshme dhe afatgjata. Gjatë diskutimeve aktive dolën në pah vështirësitë e grupit të grave, për të cilat kërkuan dhe suportin tonë, të tilla si: perzgjedhjen e produkteve, krijimin e markës së personalizuar për zonën, dizenjimin e logos, etj. Me gjithë suportin tonë në përpilimin dhe krijimin e markës së personalizuar, një tjetër vështirësi e grupit për të cilën vazhdojnë të kërkojnë suportin tonë është regjistrimi i markës. Ky proces është shumë i vështirë duke pasur parasysh që në zonën e Vrithit nuk ka asnjë subjekt të regjistruar. Gjithashtu gjatë kësaj teme trajnimi grupi i grave identifikoi vlerat e shtuara për

Joint German-Danish “Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas” (SARED)

produktet, si: rritje të burimeve të lëndës së parë, rritje të ofertës për produkte lokale cilësore, cmime me të larta për produktet finale, promovim i zonës dhe grupit të grave, etj.



4 Mars 2017 – Zhvillimi i sesionit të trajnimit të grupit të grave në zonën e Tamarës lidhur me: “Mundesitë e Markave Rajonale”.

Expert: Iris Kazazi, Ekstensionist pranë Drejtorisë së Bujqësisë Shkodër: z. Xheladin Zekaj, datë 4 Mars 2017, fshati Tamarë, Njësia Administrative Kelmend, Shkodër

16 gra të grupit të zinxhirit të vlerës në zonën e Tamarës morën pjesë në sesionin e trajnimit me temë “Mundesitë e Markave Rajonale”. Grupi i grave e vlerësoi këtë temë të rëndësishme në rritjen e njohurive dhe kapaciteteve të tyre lidhur me përfitimet që sjell nxjerrja në treg e produkteve nëpërmjet markës rajonale. Njohuritë e marra gjatë trajnimit për benefitet ekonomike që sjell marka për prodhuesin, nxitën një debat aktiv lidhur me nevojat e grave të tilla si: përzgjedhja e produkteve, dizenjimin e logos, etj. Me gjithë suportin tonë në krijimin e markës së personalizuar, një tjetër vështirësi e grupit është regjistrimi i markës, për shkak të mungesës së subjekteve të regjistruara në zonën e Tamarës. Gjithashtu, këto diskutime dhe njohuri të marra çuan në identifikimin e vlerave e shtuara për produktet e grupit të grave siç ishin: rritje të burimeve për lëndën e parë dhe të likuiditeteve, rritje të cilësisë së produkteve, zhvillimi i produkteve të reja sipas kërkesës së tregut, rritje të çmimit për produktin final si dhe promovim të zonës dhe vetë grupit të grave.


